

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datede / Izlaze: Date / Dana: 12 / 05 / 2025		
Nr. Orgv. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 114	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
 KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
 MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
 E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

PROCESVERBAL

Takimi me banorët e fshatit Prelez i Jerlive në kuadër të procesit të votimit për projektin e Buxhetimit me Pjesëmarrje

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur, Kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu, në koordinim me drejtorët e drejtorive, Njësinë për Komunikim me Publikun dhe zyrtarët tjerë komunalë, ka publikuar kalendarin për organizimin e takimeve publike me qytetarë për Buxhetimin me Pjesëmarrje.

Me datën **28.04.2025**, në fshatin **Prelez i Jerlive**, është zhvilluar procesi i votimit në kuadër të këtyre takimeve publike.

Në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësues të Komunës së Ferizajt, përfshirë edhe kryesuese e komisionit, znj. **Ganimete Shehaj**. Takimi pasoi një sesion paraprak të mbajtur më **22 prill 2025**, gjatë të cilit banorët e fshatit kishin paraqitur propozimet e tyre për projekte.

Në votim kanë marrë pjesë **18 banorë**, të cilët votuan sipas procedurës së përcaktuar, duke pasur mundësinë të përzgjedhin **një** nga **pesë** propozimet e paraqitura. Pas përfundimit të votimit, votat u numëruan në prani të banorëve. Rezultatet ishin si më poshtë:



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

1. Rregullimi i kanalit të ujit, i cili kalon përmes fshatit – 13 vota
2. Rregullimi i fushës së sportit të xhamia e re – 1 votë
3. Renovimi i shkollës së re "Ismail Qemali" – 0 vota
4. Rregullimi i kabinetit të informatikës në shkollë – 0 vota
5. Vendosja e shportave të mbeturinave dhe ulëseve në rrugët e fshatit – 2 vota

Dy fletëvotime rezultuan të pavlefshme: njëri ishte i plotësuar gabimisht (u votuan të gjitha opsionet), ndërsa tjetri nuk u vendos fare në kutinë e votimit.

Sipas rezultateve, projekti me më shumë mbështetje nga banorët ishte:

"Rregullimi i kanalit të ujit, i cili kalon përmes fshatit", me gjithsej 13 vota.

Përpilues i procesverbalit:

Xhelal Topalli

Data: 28.04.2025

Vendi: Prelez i Jerlive